

dane, e më vonë e sistemuan në njësitin special *Komando*. Xhemajli, 17 vjeç, po ashtu, aderoi në radhët e UÇK-së në qershorin e vitit 1998. Në datën **18.09.1998**, Adonisi dhe Xhemajli u nisën së bashku për të transportuar një kontingjent armatimesh nga Shqipëria për UÇK-në në Kosovë. Kanë rënë gjatë betejës me forcat e UJ-së në fshatin **Devë/Deva**, i cili ndodhet pranë kufirit me Shqipërinë. Trupat e tyre u zbuluan vetëm pas përfundimit të luftës në varrezat e Gjakovës/Đakovica. Mbetjet mortore të Xhemajlit janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në *Kodrën e Kuqe/Crveni breg*, afër fshatit Grabanicë/Grabanica.

Burimet: H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Sadri (Shaban) Lokaj

(26.04.1979, shqiptar nga Gjakova/Đakovica, pjesëtar i UÇK-së)

Sadriu e kishte mbaruar shkollën e mesme të makinerisë në Gjakovë/Đakovica. Që nga viti 1981 dhe demonstratat studentore, familja e tij kishte probleme me pushtetin serb. Sadriu u inkuadrua në UÇK në fund të marsit të vitit 1998. Ishte pjesëtar i Njësitit për Veprime të Shpejta *Shqiponjat e Zeza/Crni orlovi*, të cilën e komandonte Idriz Balaj. Emri luftarak i Sadriut ishte Hoxha. Në datën **27.09.1998**, Sadriu me dy pjesëtarë të tjerë të UÇK-së u nisën për të bërë vëzhgimin e terrenit. Në vendin e quajtur *Netice*, afër fshatit **Cërmjan/Crmljane**, ata ranë në pritë të forcave serbe. Sadriun e vranë në vend. Trupi i tij i pajetë ka mbetur në vendin e ngjarjes, sepse bashkëluftëtarët e tij nuk mundnin ta tërhiqnin atë për shkak të pranisë së forcave serbe. Pas përfundimit të luftës, babai i Sadriut, Shabani, i ka gjetur mbetjet mortore të të birit në vendin ku ai kishte rënë. Pas identifikimit, tri ditë më vonë, Sadriun e varrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Glogjan/Glođane [Deçan/Dečani].

Burimet: deklarata S.L, FDH-29025; SHFDUÇK, *Feniksët...*6, 73,74; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Miloš (Slavko) Pavlović

(26.10.1967, serb nga Nishi, i pamartuar, student, pjesëtar i UJ-së)

Miroslav (Mladen) Jocić

(30.08.1968, serb nga Tërnavë e Ulët, komuna e Prokuples, pjesëtar i UJ-së)

Miladin (Milan) Gobeljić

(24.09.1978, serb nga Shushura, komuna e Sjenicës, minator, pjesëtar i UJ-së)

Vladimir (Momčilo) Radoičić

(23.03.1979, serb nga Beogradi, automekanik, pjesëtar i UJ-së)

Ilija (Živojin) Pavlović

(2.08.1979, serb nga Beogradi, tekniku mekanik, pjesëtar i UJ-së)

Ilija dhe Vladimiri, menjëherë pas mbarimit të shkollës së mesme, shkuan në kryerjen e shërbimit të rregullt ushtarak. Përpara shkuarjes në ushtri, Miladini u punësua si minator në minierën *Shtavalj* në Sjenicë. Miroslavi dhe Miloši ishin ushtarët profesionist – Miroslavi nga viti 1992, ndërkaq Miloši nga 1993. Vladimiri me njësitin e tij u dërguan në Kosovë më 28.09.1998, ndërkaq Miroslavi, si ushtar profesionist, angazhohej kohë pas kohe në Kosovë; njësitit i Milošit u dërgua në Kosovë më 21.04.1998, u kthye më 29.07.1998 dhe sërisht u rikthye në postbllokun ushtarak të Koshares/Košare më 28.09.1998; Miladini, pas shërbimit të shkurtuar ushtarak në Valjevë, u dërgua në Nish më 28.09.1998 dhe në të njëjtën ditë ai më njësitin e tij u transferuan në Kosovë; Ilija ka qenë pjesëtar i togut vëzhgues në armatën e Nishit, nga ku e transferuan në Kosovë më 28.09.1999.

Në datën **30.09.1998**, në afërsi të **Koshares/Košare**, rreth orës 11:35, makina në të cilën gjendeshin Miloši, Miroslavi, Miladini, Vladimiri dhe Ilija, si dhe tre pjesëtarë të tjerë të UJ-së, ka rënë në pritë të pjesëtarëve të UÇK-së. Gjatë përlëshjes së armatosur, e cila zgjati afro 5 minutash, kanë mbetur të vdekur në vend Miloši, Miroslavi, Miladini, Vladimiri dhe Ilija. Dy ditë më vonë, Vladimiri u varros në varrezat Orlovaça [Beograd]. Po atë ditë, familjarët e kanë varrosur Milošin në Nish, në varrezat e quajtura Varreza të Reja. Po ashtu, në të njëjtën ditë, më 2.10.1998,